

STATUTI
I
SHOQËRISË AKSIONARE
GJIROFARMA

Në këtë Statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, më 16 Shtator 2021, ne, aksionarët, kemi hartuar këtë Statut të shoqërisë aksionare me emrin Gjirofarma ShA. Kjo shoqëri është themeluar më 11.06.2005.
- 1.2. Aksionarët aktualë të shoqërisë janë:
 - Z. Antonios Ouzas, i biri i Vasileios, i datëlindjes 07.07.1970
 - Z. Piro Karanxha, i biri i Ilias, i datëlindjes 18.11.1972
 - Z. Nikolla Gjoni, i biri i Viktorit, i datëlindjes 13.10.1962

Neni 2

Objekti

- 2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Mbledhja e përpunimi i qumështit, tregtimi i tij dhe nënprodukteve, import eksport tregti mallra të ndryshëm. Prodhimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe të frutave. Import, përpunim dhe tregtim i mishit dhe nënprodukteve të tij, si sallam etj.

Neni 3:

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat

Neni 4

Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën:
Bodrishtë, kodi postar 6006, rruga nacionale Gjirokastër-Kakavije, km 25, zona kadastrale 1234, nr. pasurie 72/30. Gjirokastër

4.2 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është: gjirofarm.al

4.3 Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: gjirofarm@gjirofarm.com

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 189.000.000 Lekë, i ndarë në 94.500 aksione të zakonshme me vlerë nominale 2.000 lekë secili. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

a) Aksionari Z. Antonios Ouzas, zotërues i 44.887,5 aksioneve me vlerë nominale 2.000 lekë secili, me vlerë të përgjithshme 89.775.000 lekë, që përben 47,50% të kapitalit të shoqërisë

b) Aksionari Z. Piro Karanxha, zotërues i 44.887,5 aksioneve me vlerë nominale 2.000 lekë secili, me vlerë të përgjithshme 89.775.000 lekë, që përben 47,50% të kapitalit të shoqërisë

c) Aksionari Z. Nikolla Gjoni, zotërues i 4.725 aksioneve me vlerë nominale 2.000 lekë secili, me vlerë të përgjithshme 9.450.000 lekë, që përben 5% të kapitalit të shoqërisë

Neni 6

Kërkesa për të paguar aksionet

6.1 Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

6.2 Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Neni 7

Llojet dhe kategoritë e aksioneve

7.1 Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfutur pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.

7.2 Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

Neni 8 Regjistri i aksioneve

8.1 Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

8.2 Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 9 Menyrat e fitimit dhe transferimit të Aksioneve

9.1 Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo transferohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

9.2 Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit 9901.

9.3 Aksionarët e tjerë ekzistues të shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes në rastet kur një aksionar kërkon të shesë aksionet e tij. Në këto raste aksionari që kërkon të shesë aksionet e tij detyrohet:

a) Të njoftojë aksionarët ekzistues për shumën e kërkuar për shitjen e aksioneve që ai zotëton. Njoftimi bëhet me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Aksionarët e tjerë kanë 20 ditë afat nga momenti i marrjes së njoftimit për të pranuar ose refuzuar blerjen e aksioneve të ofruara për shitje.

b) Në rast pranimi nga një ose disa nga aksionarët ekzistues, shitblerja e aksioneve duhet të përfundojë brenda 20 ditëve nga momenti i komunikimit për pranimin. Në rast të kundërt, aksionari që kërkon të shesë aksionet e tij është i lirë të ofrojë për shitje aksionet e tij palëve të treta njëlloj sikur aksionarët e tjerë të kenë refuzuar blerjen.

c) Në rast refuzimi nga aksionarët ekzistues, të ofrojë për shitje aksionet e tij palëve të treta jo aksionare, me një çmim jo më të vogël nga çmimi i ofruar për aksionarët ekzistues

d) Në rast se shitja e aksioneve realizohet për palë të treta, çmimi i shitjes së aksioneve duhet të paguhet nëpërmjet sistemit bankar dhe një kopje e dokumentacionit të pagesës duhet t'u vihet në dispozicion aksionarëve ekzistues.

9.4 Në rast të mospërbushjes së kushteve të parashikuara në pikën 9.3 të Statutit, shitja e aksioneve konsiderohet e parregullt.

9.5 Aksionarët ekzistues detyrohen të kthejnë përgjigje nëse pranojnë ose blerjen e aksioneve me çmimin e ofruar, brenda 20 ditëve nga data e marrjes dijeni

9.6 Në çdo rast, transferimi i aksioneve nëpërmjet shitjes ose dhurimit, duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, me të paktën tre të katërtat e votave të aksionarëve që marrin pjesë në votim.

Neni 10 Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

10.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

10.2 Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKB.

10.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

10.4 Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

Neni 11 Zvogëlimi i kapitalit themeltar

11.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.

11.2 Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të Ligjit.

11.3 Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

11.4 Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

Kreu III

Organet e shoqërisë

Neni 12 Organet e shoqërisë

- 12.1 Organet e shoqërisë aksionare janë:
- a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Këshilli Mbikqyrës
 - c) Administratori / administratorët

Neni 13 Asambleja e Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
- a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
 - f) miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
 - o) miratimin e transferimit të aksioneve nëpërmjet shitjes ose dhurimit

13.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikqyrës dhe raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

13.3 Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- d) vendimet për investime;

e) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

13.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 14

Mënyrat e Thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

14.2 Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme;
- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në Asamblenë e Përgjithshme, e cila duhet të përfshijë:
 - i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të Ligjit;
 - ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
 - iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
- c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të Ligjit;
- ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

14.3 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

- a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;
- b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;
- c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme.

14.4 Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Neni 15

Rendi i ditës

15.1 Rendi i ditës, që njoftohet sipas nenit 14 të këtij Statuti, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

15.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e Statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

15.3 Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

15.4 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 14 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë

Neni 16

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

16.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 17 i Statutit

16.2 Gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

16.3 Asambleja e Përgjithshme cakton një kryetar.

16.4 Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

16.5 Administratori ose anëtari i Këshillit të Mbikqyrës pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

Neni 17

Kuorumi

17.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit.

17.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 18 Marrja e vendimeve

18.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

18.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 13 të këtij Statuti, me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim

18.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut apo në Ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë Statut, në Ligj apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

Neni 19 Këshilli Mbikqyrës

19.1 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga tre anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

19.2 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të rizgjidhen.

19.3 Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- g) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët;

f) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

19.4 Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të Ligjit, Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

19.5 Personat e mëposhtëm janë anëtarët aktualë të Këshillit Mbikqyrës:

- a) Roland Aleksi, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal F70510128A.
- b) Dhimitër Boboli, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal H00822019N.
- c) Suzana Vasi, mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal I45626223N.

Neni 20

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

20.1 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpëstësinë e këtyre mbledhjeve.

20.2 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

20.3 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikqyrës në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

20.4 Përrjashtimet nga e drejta e votës, sipas nenit 148 të Ligjit, zbatohen edhe për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës

20.5 Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Mbikqyrës, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikqyrës dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

20.6 Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikqyrës është njëllor i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

Neni 21

Procesverbalet e Këshillit Mbikqyrës

21.1 Këshillit Mbikqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:

- a) të gjithë takimeve të Këshillit Mbikqyrës; dhe
- b) të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

Neni 22

Largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

22.1 Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës përfundon në rast se:

- a) Personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
- b) Personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- c) Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- e) Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 23

Administratorët

23.1 Këshilli Mbikqyrës emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

23.2 Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të Ligjit.

23.3 Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- e) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- f) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

- g) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- h) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- i) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- j) të miratojnë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- l) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

23.4 Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të Ligjit, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e Këshillit Mbikqyrës

23.5 Administratori aktual i shoqërisë është: z. Nikolla Gjoni, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal G21013030E

Neni 24 Shkarkimi i Administratorëve

24.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) personi nuk është më administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Këshilli Mbikqyrës në pajtim me pikën 2 të nenit 167 të Ligjit;
- b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- e) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikqyrës në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli Mbikqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 25 Dividendët

25.1 Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

25.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të

periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

25.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

25.4 Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 26

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

26.1 Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 27

Ekspertët Kontabël

27.1 Ekspert Kontabël i shoqërisë caktohet z. Robert Lulo, me Nr. Licence 471 Datë 05.03.2021.

Kreu V

Prishja dhe njoftimet

Neni 28

Prishja dhe likuidimi

28.1 Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

Neni 29

Baza Ligjore

29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 30

Mosmarrëveshjet

30.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Aksionarët
e
shoqërisë**

GJIROFARMA SH.A.